

Mostra e këlbazës

Këlbaza është flegma që nxirri me anë të kollës nga mushkëritë ose nga fyti. Nëse keni simptoma të tuberkulozit në mushkëri, do të merren disa mostra të këlbazës suaj dhe do të dërgohen në laborator. Ato më pas do të ekzaminohen me një mikroskop për të kontrolluar nëse mund të shihen baktere tuberkulozi.

Nëse bakteret mund të shihen në mikroskop, kjo quhet një provë tuberkulozi pozitive e këlbazës dhe ju mund t'ia kaloni më lehtë infeksionin të tjerëve kur kolliteni ose kur teshtini.

Nëse bakteret nuk mund të shihen në mikroskop, por testet e tjera tregojnë që ju keni tuberkuloz aktiv, kjo quhet një provë tuberkulozi negative e këlbazës. Kjo do të thotë se ju keni më pak mundësi t'ia kaloni infeksionin të tjerëve.

Testi i kulturës

Nëse kryeni një test këlbaze, laboratorit do të përpiqet të zbulojë gjithashtu nëse nga mostra mund të rriten baktere të tuberkulozit. Ky quhet një test kulture.

Nëse mendohet se ju keni tuberkuloz aktiv në një pjesë tjetër të trupit përveç mushkërive ose fytit, mund të merret një mostër e vogël ind (e quajtur biopsi), nga zona e trupit ku mendohet se ekziston tuberkulozi, ose mund të merret një sasi e vogël qelizash ose lëngu duke përdorur një gjilpërë. Kjo më pas do të dërgohet në laborator për të parë nëse bakteret e tuberkulozit mund të rriten nga mostra (kultura).

Për shkak se bakteri i tuberkulozit rritet dhe shumëfishohet ngadalë, testi i kulturës mund të zgjasë deri në 8 javë përpara se të mund të jepet një rezultat. Nëse në një pjesë të trupit tuaj përveç mushkërive gjendet tuberkuloz aktiv, juve do t'ju ofrohet një ekzaminim me reze x për krahërorin, për të kontrolluar që tuberkulozi nuk ka prekur mushkëritë tuaja.

Rreth TB Alert

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë në MB për tuberkulozin në mbarë botën. Ne mbështesim projekte në MB dhe në vendet në zhvillim duke siguruar që një numër më i madh pacientësh të marrin informacionin dhe trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.

Mbroni të gjithë familjen dhe miqtë nga TB - merrni ilaçet e TB-së

Mos harroni se Infermierja e tuberkulozit është këtu për t'ju ndihmuar dhe për t'ju këshilluar gjatë të gjithë trajtimit tuaj. Ju lutemi kontaktoni infermierin tuaj të tuberkulozit nëse nuk ndiheni mirë gjatë trajtimit tuaj ose nëse ka ndonjë gjë që jeni të pasigurt për mjekimin tuaj.

Infermierja juaj e tuberkulozit është:

Doktori juaj në spital është:

Nr. i kontaktit:

E-maili:

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë për Tuberkulozin në Mbretërinë e Bashkuar dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.



TB Alert,
Community Base,
113 Queens Road,
Brighton BN1 3XG
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert**, ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.tbalert.org

Informacioni i dhënë në këtë broshurë rreth tuberkulozit rezistues ndaj shumë ilaçeve ka si synim të japë informacion të përgjithshëm rreth subjektit. Ai nuk mendohet të zëvendësojë njohuritë, ekspertizën, aftësitë dhe gjykimin e infermieres/doktorit tuaj të tuberkulozit ose të profesionistëve të tjerë të shëndetësisë. Asnjë nga informacionet që përmban kjo broshurë nuk mendohet të përdoret për të marrë vendime për diagnoza ose për kurim. Pyetjet dhe problemet në lidhje me diagnozën dhe kurimin duhet t'i drejtohen një profesionisti të kujdesit shëndetësor.

Punim origjinal kërkimor nga North West London TB Network



Tuberkulozi (TB) dhe diagnoza e tij

je e madhe
gjatë natës
temperaturë
temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës. Me ose pa kollë
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Gjendra të ënjtura Gjendra të ënjtura
Temperaturë!! Humbje e pashpjegueshme në peshë
Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë



Çfarë është tuberkulozi?

Tuberkulozi (TB) është një infektion bakterial që haset kryesisht në mushkëri por që mund të ndikojë çdo pjesë të trupit. Ky quhet tuberkuloz aktiv.

Tuberkulozi aktiv është i mjekueshëm me ndihmën e ilaçeve dhe zgjat të paktën gjashtë muaj. Vetëm tuberkulozi i mushkërive ose fytit mund të jetë infektues dhe pjesa më e madhe e njerëzve nuk do të jenë infektues brenda dy javëve nga fillimi i marrjes së barnave.

Është gjithashtu e mundshme të keni tuberkuloz të fshehur ose infektim me tuberkuloz. Kjo do të thotë se ju i keni mikrobet brenda organizmit, por trupi juaj po i mban ato nën kontroll dhe pengon që të sëmurëni. Personat me tuberkuloz të fshehur nuk kanë asnjë simptomë dhe nuk mund t'ua kalojnë infeksionin të tjerëve.

Si zbulohet tuberkulozi?

Kur dikush me tuberkuloz të mushkërive ose të fytit kollitet ose teshtin, mikrobet mund të përhapen në ajër në formën e piklave dhe njerëzit e tjerë mund t'i marrin me anë të frymëmarrjes. Njerëzit që kanë më shumë gjasa të infektohen me tuberkuloz, janë ata të cilët kanë kaluar një kohë të gjatë pranë personave me tuberkuloz (zakonisht partnerët dhe njerëzit e tjerë brenda një shtëpie, ose shumë rrallë kolegët e afërt të punës). Tuberkulozi nuk përhapet nëpërmjet pështymës ose shkëmbimit të objekteve.

Cilat janë simptomat e tuberkulozit?

Simptomat më të zakonshme të tuberkulozit në mushkëri janë:

- **Një kollë që zgjat më shumë se tre javë.** Kjo mund të fillojë si një kollë e thatë irrituese, që mund të mos jetë ndryshe nga kolla që vjen nga infektimi i krahavorit. Kolla e tuberkulozit do të vazhdojë për javë ose muaj duke vazhduar të keqësohet.
- **Humbje jo e arsyetueshme e peshës.**
- **Ethe dhe djersitje e madhe gjatë natës.** Temperaturat të cilat shoqërojnë sëmundjen ndodhin zakonisht gjatë natës, duke bërë që pacienti të djersitë shumë, aq sa mund të jetë e nevojshme që të ndërtoni të gjitha rrobat e gjumit në mes të natës.
- **Një ndjesi e përgjithshme dhe e pazakontë lodhjeje dhe sëmundjeje.**
- **Humbje oreksi.** Të gjitha këto simptoma mund të jenë gjithashtu shenja të problemeve të tjera.

Si mund ta kuptoj që kam tuberkuloz?

Nëse keni një ose më shumë prej këtyre simptomave, ju duhet të vizitoheni te mjeku juaj i familjes (megjithëse çdonjëra prej tyre mund të tregojë një kusht tjetër për t'u kontrolluar te mjeku juaj). Nëse ata mendojnë se ka mundësi të keni tuberkuloz, ata do t'ju drejtojnë te klinika lokale e sëmundjeve të krahavorit ose te klinika e tuberkulozit, ku do të kryeni testet.

Nëse njihni dikë me tuberkuloz infektiv, doktorët do e kenë pyetur më parë atë person se me kë kanë kaluar më shumë kohë. Shërbimet shëndetësore më pas do të kontaktojnë të gjithë personat që ata mendojnë se mund të jenë të rrezikuar nga infektimi dhe do u kërkojnë atyre të paraqiten për teste.

Testet e ndryshme janë:

Testi i lëkurës (Mantoux)

Testi i lëkurës tregon nëse trupi juaj ka qenë ndonjëherë i ekspozuar ndaj mikrobeve të tuberkulozit. Ju mund të keni qenë të ekspozuar duke marrë vaksinën BCG (që përmban një formë të parrezikshme të mikrobët) ose nëpërmjet thithjes së mikrobët të tuberkulozit. Ai quhet testi Mantoux dhe ka të bëjë me injektimin e drejtpërdrejtë të një sasive të vogël lëngu, të quajtur Tuberculin, në shtresën e parë të lëkurës suaj me anë të një gjilpërë të hollë dhe të një shiringe. Ajo mund t'ju djegë pak por nuk do t'ju dhembë për një kohë të gjatë. Vendi i testit lexohet 2-3 ditë më vonë.

Nëse testi është pozitiv, do të shfaqet një pjesë e kuqe e ngritur. Ju nuk duhet ta mbulon vendin e testit me një leukoplast, ta kruani ose ta fërkoni atë, ose të vendosni ndonjë vaj, krem ose produkt kozmetik. Ju mund ta lani atë normalisht me ujë dhe me sapun. Ka disa shkallë të ndryshme madhësie dhe skuqeje. Doktorit ose infermierja në klinikë do e ekzaminonë testin dhe do ju shpjegojnë rezultatet.

Çfarë do të thotë një test pozitiv i lëkurës?

Një test pozitiv i lëkurës mund të nënkuptojë gjëra të ndryshme: Ju keni marrë vaksinën BCG. Nëse po, pritët një reaksion i vogël dhe kjo është normale. Ju mund të keni tuberkuloz të fshehur. Juve mund t'ju kërkojë që të kryeni një test gjaku për të konfirmuar infeksionin e fshehur. Ju mund të keni tuberkuloz aktiv dhe do të keni nevojë të vizitoheni nga një doktor për teste të mëtejshme.

Çfarë do të thotë një test negativ i lëkurës?

Kjo do të thotë se ju ndoshta nuk i jeni ekspozuar më parë baktereve të tuberkulozit. Por mund të thotë gjithashtu se ju jeni testuar shumë herët ose se trupi juaj nuk është i aftë të reagojë ndaj testit.

Testi mund të duhet të përsëritet pas 6 javësh. Një rezultat negativ nuk do të thotë gjithmonë se ju nuk keni tuberkuloz.

Nëse ju nuk keni tuberkuloz por mendohet se jeni shumë më i rrezikuar se shumica e njerëzve për ta marrë atë për shkak të vendit ku jetoni ose ku punoni, atëherë juve mund t'ju ofrohet vakcina BCG. Nëse imuniteti juaj është i rrezikuar (si p.sh. njerëzit me HIV ose pacientët që kanë kryer transplante) juve nuk do t'ju ofrohet BCG-ja, sepse rreziku i vaksinës me mikrob të gjallë në këto raste është shumë i lartë.

Analiza e gjakut

Ka një analizë të veçantë gjaku për tuberkulozin. Nëse testi i lëkurës del pozitiv dhe ju keni patur kontakt me dikë të infektuar me tuberkuloz (por nuk keni shfaqur ndonjë simptomë), juve mund t'ju kërkojë ta kryeni këtë analizë për të kontrolluar nëse keni tuberkuloz të fshehur. Nëse rezultati i analizës së gjakut është pozitiv, juve mund t'ju bëhen teste të tjera për të parë që nuk keni tuberkuloz aktiv.

Personave me tuberkuloz të fshehur nën 35 vjeç mund t'ju ofrohet një seri mjekimesh që zgjasin tre ose gjashtë muaj. Personave mbi 35 vjeç dhe që nuk janë të infektuar me HIV nuk do u ofrohet mjekim sepse ekziston një rrezik i lartë i dëmtimit të mëlçisë nga barnat kundër tuberkulozit. Personave të infektuar me HIV u ofrohet gjithmonë mjekim, pavarësisht moshës që kanë, sepse tuberkulozi i fshehur mund të aktivizohet më lehtësisht dhe më pas do të shpejtojë sëmundjen HIV.

Rrezet X të krahavorit

Nëse keni simptoma tuberkulozi, ju do të dërgoheni për një test të krahavorit me rreze X. Kjo do u tregojë doktorëve nëse ka ose ka patur tuberkuloz në mushkëritë tuaja.